



Nuk ka te sosur polemika per qeshtjen Albi Alla.Kujtojme qe ne ndeshjen e fundit midis Flamurtarit dhe Bylisit, mbrojtesi Alla i Bylisit u ndeshkua me karton te verdhe por pamjet filmike treguan qe gjyqtari ishte gabuar.Ne kete menyre drejtuesit e Bylisit kerkuan anullimin e kartonit qe ishte i rende pasi skualifikonte lojtarin ne ndeshjen me Vllaznine.Pak para fillimit te ndeshjes Bylis-Vllaznia presidenti ballshiot Kapllanaj u shpreh:"Ne si klub duke u bazuar ne pamjet filmike i beme nje kerkese federates per anullimin e kartonit te Alles.Ne ankimimin e kemi bere ne baze te rregullores se FSHF-se duke ditur qe edhe me pare ka pase raste te tilla.Komisioni u mblodh te premten dhe ne perfundim ishte vendosur qe kartoni te hiqej sepse i dhene ne menyre te padrejte.Ne kemi nje sms qe verteton kete vendim.Sms eshte nga ana e antareve te federates.Kemi pritur tere ditën dje dhe sna ka ardhur asnje komunikim zyrtar.Ne menyre krejt tendencjoze Federata hape zyrat te djelen qe eshte dite pushimit dhe na dergon nje komunikim ku thuhet qe nuk eshte kompetence e komisionit te disiplines te marre nje vendim te tille.Nese kishte deshire te mire qe te zgjidhej ky problem vendimi duhej te na komunikohet 2-3 dite para ndeshjes qe te na jepej mundesia te ankoheshim ne zyren e duhur dhe vetem 2 ore para fillimit te ndeshjes".